


# Mbrojtja shëndetësore për punonjësit e bujqësisë

## La tutela sanitaria per i lavoratori agricoli



### FAI CISL PADOVA ROVIGO

#### Padova e Provincia:

Baratto Gilberto: 335 7379154

Cerato Daniele: 335 7353348

Narzisi Giuseppe: 3336457786

#### Rovigo e Provincia:

Laurenti Stefano: 333 6457659

Tugnolo Leonardo: 366 6529311

Bononi Roberta: 331 6954888

E-mail: [fai.padova.rovigo@cisl.it](mailto:fai.padova.rovigo@cisl.it)

## Mbrojtja shëndetësore për ty dhe për familjen tënde

*Je punonjëse apo punonjës në bujqësi? Ke pasur shpenzime shëndetësore për ekzaminime specifike dhe/ose për ndërhyrje kirurgjike për veten apo për familjen? Tani, të vjen në ndihmë FISA (Fondi plotësues Shëndetësor i punonjësve në bujqësi, në kopshtari e në fidanishte)*

Bëhet fjalë për një instrument të rëndësishëm, të parashikuar nga kontrata e punës, i cili është shumë i dobishëm për ty dhe pjesëtarët e familjes tënde në rast ekzaminimesh mjekësore, shtrimi në spital ose aksidenti në vendin e punës.

FISA u garanton të gjithë punonjësve të bujqësisë dhe të gjithë atyre që punojnë në kopshtari, në fidanishte dhe familjeve të tyre, një sistem ndihme shëndetësore që i shtohet Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, si dhe ndihma ekonomike shumë të dobishme në rast nevojë.

**Falë kontratës kombëtare të punës, të nënshkruar nga sindikata jonë, kostoja e Fisa-s, mbulohet tërësisht nga ndërmarrja. Punëtorët nuk paguajnë asgjë për të hyrë në këtë Fond, pra shërbimet e tij janë falas.**

## Shërbimet shëndetësore plotësuese që garanton Fondi janë:

*Për të gjithë familjen*

- Shtrim në spital me dhe pa ndërhyrje kirurgjike
- Dëmshpërblim për lindje pa operacion
- Day Hospital kirurgjikal ose për kura dhe terapi për trajtimin e patologjive onkologjike (kimioterapi, kobaltoterapi, radioterapi) dhe për dializë
- Ndërhyrje kirurgjike ambulatoriale për shërbime dermatologjike dhe okulistike
- Ekzaminime shumë të specializuara (rezonancë magnetike, TAC, etj.)
- Trajtime fizioterapie për rehabilitim pas një aksidenti e pas një patologjie të veçantë
- Proteza/mjete ndihmëse mjekësore ortopedike dhe akustike
- Trajtime dentare pas një dëmtimi të shkaktuar nga një aksident në punë

*Vetëm për të regjistruarin në Fond*

- Pamundësi për të qenë i vetëmjaftueshëm dhe i pavarur
- Aksidente në punë
- Analiza gjaku
- Vizita të specializuara
- Fizioterapi, kineziterapi, rehabilitim kardiologjik dhe neuromotor pas një shtrimi në spital si pasojë e një sëmundjeje ose e një aksidenti

*Për informacione të mëtejshme mund t'u drejtolesh zyrave të FAI CISL*

## Shërbimet Eban



EBAN (Enti bilateral bujqësor kombëtar), i përbërë nga përfaqësues të sindikatave të bujqësisë dhe i parashikuar nga kontrata kombëtare, siguron, ndër të tjera, një sërë shërbimesh ekonomike në ndihmë të të ardhurave të familjeve. Punëtorët e bujqësisë me kontratë me kohë të pacaktuar, të punësuar nga ndërmarrje bujqësore që kanë derdhur me rregull kuotat e parashikuara nga EBAN, gëzojnë të drejtën e dëmshpërblimeve të mëposhtme në këto raste:

- **Pushim nga puna:** nëse pushohen nga puna gjatë katërmujorit të fundit të vitit, duhet të dëmshpërblehen me 30% të pagës më të ulët të kategorisë së dytë të kontratës kolektive kombëtare të punës për tre muaj.
- **Lindje e një fëmije:** Mëmësi/Atësi, prindërit gjatë mungesës fakultative nga puna, mund të paguhet me 40% të pagës më të ulët të kategorisë së dytë të kontratës kolektive kombëtare të punës për gjashtë muaj.
- **Patologji onkologjike:** gjatë periudhës së konvaleshencës pa pagesë (sipas nenit 60 dhe 61 të Kontratës Kolektive Kombëtare të Punës), kanë të drejtën e 80% të pagës më të ulët të kategorisë së dytë të kontratës kolektive kombëtare të punës për gjashtë muaj.
- **Viktima të dhunës gjinore:** gratë që marrin pjesë në programe mbrojtjeje si pasojë e dhunës gjinore dhe që kanë marrë leje nga puna, kanë të drejtë të paguhet me 100% të pagës më të ulët të kategorisë së dytë të kontratës kolektive kombëtare të punës për dy muaj leje, që merren pas tre muajve të parashikuara me ligj.

*Për informacione të mëtejshme mund t'u drejtolesh zyrave të FAI CISL*